



Temat e Takimit:	<ol style="list-style-type: none">1. Raporti mbi vizitën në Kosovë nga Augustin Berisha në lidhje me mundësitë e renovimit të Kishës së Shën Nënë Tereza në Dugajevë2. Prezantimi online i projektit të ri dhe raporti mbi arritjet deri më tani në aspektin organizativ dhe financiar3. Diskutim në plenum mbi hapat e ardhshëm4. Të dhënat e llogarisë për donatorët
Data:	13.10.2024
Ora:	18:30 – 20:30
Vendndodhja:	Online – Zoom-Meeting
Pjesëmarrësit:	Augustin Berisha, Betim Gojani, Dedë Berisha, Don Ambroz Demaj, Gentian Berisha, Josip Gjonaj, Laura Berisha, Mark Berisha, Marjan Gojani, Mirash Gojani, Zef Shala, Zog Berisha, Kolë Berisha
Kryesuesi:	Stafi Organizativ
Dokumentator:	Kolë Berisha

1. Raporti mbi vizitën në Kosovë nga Augustin Berisha në lidhje me mundësitë e renovimit të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë

Marjan Gojani dhe Kolë Berisha hapen mbledhjen duke falenderuar dhe përshëndetur të pranishmit. Më pas, mori fjalën Don Ambroz Demaj, i cili gjithashtu përshëndeti dhe falenderoi të pranishmit, si dhe i informoi ata mbi ngjarjet e zhvilluara në këtë drejtim.

Pas kësaj, Augustin Berisha raportoi mbi vizitën e tij në Kosovë, duke theksuar mundësitë për renovimin e Kishës ekzistuese të Shen Nënë Terezës në Dugojevë. Ai gjithashtu paraqiti në detaje vlerësimin nga tre inxhinierë, të cilët arritën në përfundimin se renovimi i Kishës nuk është i leverdishëm për shkak të kostove dhe jo përmbushjes së kriterëve të qëllimit të këtij projekti. Pas kësaj, u ofruan mundësitë për të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje të shpreheshin dhe të ndanin mendimet e tyre mbi këtë çështje.



2. Prezantimi online i projektit të ri dhe raporti mbi arritjet deri më tani në aspektin organizativ dhe financiar

Gjatë mbledhjes, Ded Gojani, Zef Shala, Mirash Gojani dhe shumë pjesëmarrës të tjerë parashtruan pyetje lidhur me arritjet në fushën e donacioneve nga institucionet ndërkombëtare. Kolë Berisha sqaroi rrjedhat e deritanishme dhe pengesat në këtë drejtim, por shprehu optimizëm se, nëse ne i kryejmë detyrat tona, do të kemi gjasa të mira për mbështetje nga disa institucione. Ai theksoi se shumata e donacioneve nuk janë bërë të njohura deri më tani për shkak të burokracisë së këtyre institucioneve.

Më pas, Don Ambroz Demaj mori fjalën dhe sqaroi me përpikëri rrjedhat e deritanishme, si dhe propozimet e marra nga disa mbledhje paraprake. Ai sqaroi se në këto mbledhje është propozuar që çdo kryefamiljar që jeton në diasporë të dhurojë nga 1500 euro, ndërsa kryefamiljarët që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë të kenë lirinë të kontribuojnë sipas mundësive dhe vullnetit të tyre. Ai gjithashtu la të hapur mundësinë që, nëse dikush shpreh dëshirën për të dhuruar më shumë, kjo do të ishte e mirëpritur dhe u falenderua për këtë gatishmëri.

Më pas, u zhvilluan diskutime dhe vlerësime të arsyeshme mbi këto propozime nga pjesëmarrës të tjerë, përfshirë Mirash Gojani, Marjan Gojani, Zef Shala, Petrit Gojani, Augustin Berisha, Josip Gjonaj, Zog Berisha, Mark Berisha, Betim Gojani dhe të tjerë. Në fund, të gjithë ranë dakord që kjo shumë e propozuar të mbetet në fuqi.

2

3. Diskutim në plenum mbi hapat e ardhshëm

Gjatë diskutimit në plenum, u zhvillua një debat i qartë dhe konstruktiv, ku morën pjesë shumë propozues. Në përfundim, u miratuan këto vendime në mënyrë unanime:

a) Donacionet nga kryefamiljarët: Çdo kryefamiljar që jeton në diasporë do të kontribuojë me nga 1500 euro për këtë projekt. Ndërsa kryefamiljarët që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë do të kenë lirinë të kontribuojnë sipas mundësive dhe vullnetit të tyre. Po ashtu, u la e hapur mundësia për ata që dëshirojnë të dhurojnë shuma më të larta.

b) Forma e dhurimit: Donacionet do të mund të bëhen në dy këste, dhe deri më 31 mars 2025, duhet të përfundojë kjo fushatë e mbledhjes së donacioneve nga Dugojevasit, pa marrë parasysh se ku ata jetojnë.

c) Kthimi i donacioneve: Nëse deri më 31 mars 2025 nuk arrijmë të grumbullojmë shumën e nevojshme për kryerjen e punimeve të planifikuara (punimet e vrazhda), propozimi i Marjan Gojanit për kthimin e parave të të gjithë donatorëve deri në këtë datë do të hyjë në fuqi.



d) Mbledhja e ardhshme: Petrit Gojani propozoi që në dhjetor të këtij viti, stafi organizativ të organizojë një mbledhje online për të shqyrtuar gjendjen e grumbullimit të donacioneve dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshëm. Ky propozim u miratua nga të gjithë pjesëmarrësit.

e) Propozimi për Kontrollin e Mbarëvajtjes së Punimeve: Kolë Berisha propozoi katër kandidatë për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e punimeve: Gjelo Shala, Tom Gojani, Nikollë Ukgjini dhe Augustin Berisha. Ky propozim do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

4. Tee dhënat e llogarisë për donatorët

Emri i përfituesit: Dioqeza Prizren-Prishtinë, Kisha Shën Nënë Tereza, Dugojevë

Numri i Llogarisë: **1501090004417744**

Banka: **Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.**

Adresa e Bankës: Rr. Robert Doll Nr. 101, Prishtinë, Kosovë

Lloji i Llogarisë: Business Current Account

Customer ID: **100160926**

Mbiterheqje e lejuar: **Jo**

Njoftim për Nënshkrimet për Menaxhimin e Fondeve:

Në mbledhje u vendos në mënyrë unanime se, për heqjen e mjeteve financiare të mbledhura për projektin, kërkohet, përveç nënshkrimit të Don Ambroz Demajt, edhe nënshkrimi i mëposhtëm nga katër individë të caktuar për të garantuar transparencën dhe përgjegjësinë në menaxhimin e këtyre fondeve.

Nënshkrimet e Kërkuara:

1. **Dedë Kolë Gojani**
2. **Nikollë Mark Nikprelaj**
3. **Sokol Zef Syla**
4. **Filip Vlash Gjonaj** ose **Riqard Luz Gjonaj** (sipas marrëveshjes me Don Ambroz Demajn)

Të gjithë këta individë duhet të nënshkruajnë këtë dokument për të konfirmuar autorizimin e heqjes së fondeve dhe për të siguruar që çdo transaksion të jetë në përputhje me qëllimet e projektit.

Faleminderit për mbështetje dhe bashkëpunim! Stafi Organizativ